



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

A mund të kërkoj kompensim nëse kryesi i veprës nuk është identifikuar?


Po. Ju si viktimë mund të kërkonit kompensim nëse dëmtshpërblimi nuk mund të realizohet nga i pandehuri në rast se ai mbetet i panjohur. Ju mund të kërkonit kompensim po ashtu edhe në rrethanat tjera, si p.sh nëse i pandehuri ka vdekur, nëse është personi i gabuar dhe lirohet, nëse pas 2 vjetve nga zbulimi i veprës nuk është ngritur aktakuzë, nëse i pandehuri nuk është penalisht i përgjegjshëm, apo nëse përmbarimi në gjykatë nuk mund të zbatohet.

Si mund ta parashtror kërkesën për kompensim dhe ku mund ta dorëzoj atë?

Plotësoni formularin për parashtrimin e kërkesës për kompensim të viktimave të krimit, të cilën mund ta gresh në Zyrat për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave në të gjitha Prokuroritë Themelore, në zyrat për ndihmë ligjore falas, apo përmes internetit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë (www.md-ks.net). Gatë plotësimin të kërkesës, lexoni me kujdes instruksionet dhe dokumentet përcjellëse që duhen bashkëngjitur. Formularin dhe dokumentet përcjellëse i kompletioni dhe i dorëzoni në Ministrinë e Drejtësisë, në adresën: Ish-ndërtesa e Rilindjes, Prishtinë 10.000, ose edhe duke i skanuar dokumentet i dërgoni në e mail adresën: kkvk.m@rks-gov.net.



U.S. Embassy Pristina
Arberia/Dragodan,
Nazim Hikmet 30
Pristina, Kosovo
Phone: + 381 38 59 59 3000
Fax: + 381 38 549 890



Programi i Kompensimit të Viktimave të Krimit mundëson kompensimin financiar të viktimave të krimeve të dhunshme për disa dëmtime që kanë rezultuar nga vepra penale. Komisioni i Kompensimit të Viktimave të Krimit shqyrton kërkesat për kompensim dhe merr vendime duke respektuar nevojat dhe të drejtat e viktimave të krimit.

Veprat penale të kompensueshme

Veprat penale të kompensueshme janë ato vepra që rezultojnë me vdekjen e viktimës, lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit fizik apo mendor si:

- Vrasja
- Trafikimi me njerëz
- Dhunimi
- Keqpërdorimi seksual i fëmijëve
- Veprat penale që bien brenda përkufizimi të dhunës në familje sipas Ligjit për mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Kushtet formale

- Të jetë shtetas ose banor i përhershëm i Republikës së Kosovës
- Të jetë shtetas i cilitdo shtet, me të cilin Republika e Kosovës ka reciprocitet apo
- Të jetë shtetas i shtetit anëtar të BE-së.

“Programi i Kompensimit është mundësia e fundit- Viktima duhet të kërkojë fillimisht dëmshpërblim nga i pandehuri në gjykatë”

Pyetje të shpeshta

Çka është Programi i kompensimit të viktimave të krimit? Programi për kompensimin e viktimave të krimit që financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ia mundëson viktimave të veprave të dhunshme të kompensueshme, të aplikojnë për kompensim financiar për dëmet si pasojë e veprës penale.

A kompenohen të gjitha veprat penale?

Jo. Ligji përcakton disa lloje të veprave të dhunshme të cilat hyjnë në kategorinë e veprave të kompensueshme. Ligji ia jep mundësinë komisionit që të shqyrtojë dhe të vendos edhe për kërkesat e pranuar nga viktimat e veprave tjera të dhunshme të cilat për shkak të natyrës së tyre dhe pasojës së shkaktuar, mund të arsyetojnë kompensimin, e veçanërisht nëse janë viktimë e ndjeshme. Ligji po ashtu i përcakton kushtet formale dhe material të cilat viktimat duhet t'i plotësojnë për të pasur të drejtën për kompensim.

Kush ka të drejtë të kërkojë kompensim?

Në përgjithësi, viktimat ka të drejtë të kërkojë kompensim për veten. Në disa raste të caktuara, kompensim mund të kërkojnë edhe anëtarët e familjes, kujdestari ligjor apo vartësit e viktimës, si vijon:

- Për vuajtje si pasojë e humbjes së anëtarit të familjes (viktimës)
- kur kanë qenë të mbajtur nga viktimat e ndjerë që nuk e kanë realizuar të drejtën e kompensimit;
- kur kanë paguar për shpenzimet e varrimit për viktimën e ndjerë.
- Kur kanë paguar shpenzimet mjekësore dhe të hospitalizimit të viktimës dhe nëse viktimat vdes para dorëzimit të kërkesës.
- nëse viktimat vdes dhe Komisioni veçse ka marrë vendim për kompensimin e viktimës dhe transferi nuk është realizuar

Kush mund ta parashtrorë kërkesën për kompensim?

Vet viktimat apo parashtruesit tjetër të kërkesës që mund të jetë si p.sh. personi i autorizuar i viktimës, kujdestari ligjor, anëtar i familjes, etj.

A mund të kompenohem për të gjitha dëmet dhe shpenzimet?

Ju do të kompenoheni për dëmet dhe shpenzimet e bëra të cilat do t'i vlerësojë dhe për të cilat do të vendos Komisioni. Nuk kompenoheni për shpenzimet e mbuluara nga burimet tjera, fondet publike dhe tarifa të avokatit për parashtrimin e kërkesës. Ju mund të kërkonit kompensim për:

- Lëndime të rënda fizike apo dëmtimi i shëndetit (maksimumi 7,000 Euro);
- Çrregullime të rënda të shëndetit mendor (maksimumi 5,000 Euro);
- Vuajtje si pasojë e humbjes së anëtarit të familjes (maksimumi 3,000 Euro);
- Shpenzime mjekësore dhe hospitalizimit (maksimumi 10,000 Euro);
- Dëmet për pajisjet mjekësore të shkatërruara (maksimumi 3,000 Euro);
- Humbjen e aftësisë për punë apo humbja e të drejtës në mbajtje (maksimumi 3,000 Euro);
- Shpenzime të funeralit (maksimumi 3,000 Euro);
- Shpenzimet procedurale për parashtrimin e kërkesës për kompensim (e papërcaktuar).

A mund të kem qasje të menjëhershme në programin për kompensim?

Qasje të menjëhershme kanë vetëm viktimat fëmijë dhe viktimat e huaja të trafikimit kur kryesi i veprës penale mbetet i panjohur për 3 muaj nga raportimi i veprës.